



VEPRIMI ËSHTË I PLOTËFUNDËSHËM
 DOKUMENTI I PRAVNOËSNAJDA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I DROSEVAC

P.nr.668/2017

07-08

20 17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Lavdije Brahim, në çështjen penale kundër [REDAKTUAR] nga fsh [REDAKTUAR], Komuna Deçan, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2096-7/15 të dt.02.03.2017, përshkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par 1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, mbrojtësit e të akuzuarit av [REDAKTUAR] dhe të akuzuarit, me dt. 28.06.2017 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] nga fsh [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR] i lindur me dt [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR], e vajzërisë [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, Student, me numër personal [REDAKTUAR], mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

Me datë 06.11.2015, rreth orës 07.40, në rrugën magjistrale Ferizaj-Shtime, përkatësisht në fshatin Llojza, Komuna Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës "VW Passat", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nerzit 71/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, ndërmerr veprimin e tejkalimit pa u siguruar mirë se me këtë veprim nuk do ti rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion ku me pjesën e përparme e godet në anën e majtë të pasme automjetin e markës "VW Golf", me targë të regjistrimit [REDAKTUAR] të cilin e drejtonte [REDAKTUAR], me të cilin rast pos dëmeve materiale në të dy automjetet lëndime të lehta trupore pëson [REDAKTUAR] lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore, të datës 26.02.2017.

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarin e:

G J Y K O N
M E D Ë N I M M E G J O B Ë

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 /njëqindë e pesëdhjetë / Eurosh, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Të dëmtuarit: [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] që të tre nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna-Shtime, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2096-7/15 të dt.02.03.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna Deçan, me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.28.06.2017 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, i akuzuari [REDAKTUAR] dhe mbrojtësi i tij me autorizim [REDAKTUAR]

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestër i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drerjtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë

mundësi të deklarohej mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR] ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet si në dispozitiv të aktit akuzues, dhe ka theksuar se është e vërtetë se ka ndodhur ai aksident, të dëmtuarit i ka vizituar, ku të njëjtit kanë qenë mirë me shëndetin, ka lutur Gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme dhe se asnjëherë nuk ka qenë i dënuar për asnjë veprë penale dhe ndjen shumë keqardhje për atë se qfar ka ndodhur i ka propozuar gjykatës që ti shqipton një dënim më të butë me që është duke student.

Në shqyrtimin fillestarë mbrojtësi i të pandehurit me autorizim av [REDAKTUAR] ka deklaruar: se pranimi i fajësisë nga i mbrojturi i tij është bërë komform nenit 248 të procedurës penale, respektivisht i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimin e ka bërë pas konsultimit me mbrojtësin e tij, si dhe pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare, pranimi mbështetet në provat dhe faktet të cilat gjenden në shkrirat e lëndës gjykatës ka propozuar që këtë pranim fajësie ta aprovoj pasi që është komform ligjit. Me rastin e përcaktimit të llojit të dënimit gjykatës I ka propozuar që si rrethanë posaqerisht lehtësuese të merr pranimin e fajësisë qysh në shqyrtimin e parë fillestare faktin se para kësaj gjykate u pendua dhe ka premtuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesheshëm, i njëjti është i moshës së re, dhe është duke i vijuar studimet, është hera e parë që bie ndesh me ligjin ndërsa gjykatës i ka propozuar që ti shqiptoj një dënim sa më të butë respektivisht dënim me gjobe për arsye se procedura e fshirjes së evidencës nga personat e dënuar është më e shkurtër e në të kundërtën çdo dënim tjetër do të sjell pasojat juridike pasi që i njëjti është student në përfundim të fakultetit dhe do të sjell probleme në punësim.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurri i shtetit Ismet Rrahmani ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë komform ligjit, edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkrirat e lëndës i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe

ti shqiptoi sanksion penal të parapar me ligj përmes të cilit do të arrihet qëllimi ndëshkëmor, ndërsa me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana lehtësuese të akuzuarit ti merr pranimin e fajësisë nga ana e tij gjendjen ekonomike që e përshkrojnë gjatë mbrojtjes së dhënë dhe premtimet se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale gjegjësisht në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë ligjore dr. [REDAKTUAR] i dt.26.02.2017, në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit rrugor ing. [REDAKTUAR] i dt.18.02.2017, si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata vërtetoi se i akuzuari ka kryer veprën penale penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e tij në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe faktin se i akuzuari është student i gjendjes jo të mirë materiale nuk ka të dhëna se më herët të ketë qenë i gjykuar me aktgjykim dënues të formës së prerë për vepra penale dhe mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata i të akuzuarit i shqiptoi dënim dënimi me gjobë në shumë prej 150 /njëqindë e pesëdhjetë / Eurosh, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me të arrihet qëllimi ndëshkëmor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] që të tre nga fsh [REDAKTUAR] Komuna-Shtime, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve gjyqësore në shumën prej 60,88 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P nr.668/2017 datë 28.06.2017

Zyrtare Ligjore

Lavdiqe Brahim

Gjyqtari

Adem Shabani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet
ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.